

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA****GJS-2023-001**

Ushtruesja e Detyrës së Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Mejreme Memaj, bazuar në nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga pala V.S., për inicim të procedurës disiplinore ndaj Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë A.Sh. – R., më datë 07.02.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paraqitur nga pala V.S., ndaj Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë A.Sh.-R..

A r s y e t i m

Pala V.S., nga Prishtina, më 13 janar 2023 ka paraqitur ankesë ndaj Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë A.Sh.-R., të cilën ankesë ia ka drejtuar autoritetit jo kompetentë kryesuesit të Këshillit Gjyqësor.

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës po të njëjtën datë konform nenit 9 par.2 të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokuroreve e ka përcjellë ankesën tek Gjykata Supreme si autoritet kompetent sa i përket pretendimeve të shkeljeve disiplinore të Kryetares së Gjykatave Themelore dhe Kryetarit të Gjykatës së Apelit (neni 9 par.1 nënpar.1.2 i ligjit të lartcekur).

Parashtruesja e ankesës V.S., pretendon se kryetarja e gjykatës ka bërë shkelje disiplinore ngase nuk e ka shqyrtuar ankesën e saj të paraqitur ndaj gjyqtares A.N.-M., brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, dhe ka kërkuar që konform ligjit të lartcekur respektivisht par.7 të nenit 9 të ndërmerren masa ndaj saj. Po ashtu, ankuesja thekson se kryetarja nuk ka vendosur lidhur me kërkesën e saj për përjashtimin e gjyqtares A.N.–M., dhe meqë kryetarja e gjykatës nuk ka vendosur lidhur me kërkesat e saj dyshon në paanësinë e saj për çka ka kërkuar edhe përjashtimin e saj për të vendosur lidhur me kërkesën për përjashtim.

Me qëllim të vërtetimit bazës së arsyeshme siç kërkohet me ligj të pretendimeve të lartcekura si autoritet kompetent kam kërkuar nga kryetarja e gjykatës të deklarohet lidhur me këtë rast dhe kam pranuar deklaratën e të njëjtës.

Në deklaratën e saj kryetarja thekson se më datë 13.12.2022, nëpërmes postes elektronike (emal-it) nga V.S., ka pranuar kërkesë për inicim të procedurës disiplinore për gjyqtaren A. N.-M., me pretendim se gjyqtarja nuk e ka trajtuar lëndën e evidentuar me numër A.nr.2401/2022 (2022:210815), me kohë sepse padinë e ka dorëzuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë më 13.10.2022, dhe gjyqtarja përveçse që ka tejkaluar të gjitha afatet ligjore rreth një vendimi final apo caktimit të ndonjë seance, ka nxjerr aktvendim dëmtues për palën, dhe atë në kundërshtim me ligjin, ku refuzon kërkesën për kthimin në punë, duke e shkelur ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve nr.06/L-085, neni 24 paragrafi 4 dhe 5. Po ashtu nga parashtruesja V.S., me datë 28.12.2022, përmes postës elektronike (emal-it), ka pranuar edhe një kërkesë për përjashtimin e të njëjtës gjyqtare nga lënda me pretendim se meqenëse ka kërkuar inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares ka kërkuar edhe përjashtimin e saj. Si autoritet kompetent, ka ndërmarr të gjitha veprimet në drejtim të procedimit të kërkesës së parashtrueses, si sigurimin e shkresave të lëndës dhe marrjen e deklaratës nga gjyqtarja. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore dhe deklaratës së gjyqtares, më datë 12.01.2023, kam nxjerr aktvendimin AD/GJTHPR/44/22, me të cilin janë refuzuar pretendimet e palës si të pabazuara, i cili vendim të njëjtën ditë edhe është ekspeduar nëpër mjet postës, kurse çështja e vonesës së shpërndarjes së vendimeve është çështje e postës së Kosovës, dhe nuk është e mundur të kontrollohet nga gjykata. Deklaratës ia ka bashkëngjitur fletë dërgesën e pranimit të aktvendimit nga pala ankuese me 16.01.2023”, dëshmitë e dorëzimit në postë- kopjen e fletores së dorëzimit dhe fletë kthesat). Si kryetare e gjykatës ka vendosur që një herë ta trajtoj ankesën disiplinore, pastaj kërkesën për përjashtim, pasi që të dy kërkesat kanë qenë të ndërlidhura, pala ankuese ende pa marrë përgjigje për ankesën disiplinore, ka kërkuar përjashtimin e gjyqtares nga rasti, duke paragjykuar vendimin disiplinor, ndërsa ligji nuk parasheh ndonjë afat ligjorë lidhur me trajtimin e kërkesës për përjashtim të gjyqtarëve. Më 17.01.2023 është njoftuar nga nënkryetari i Gjykatës se ankuesja ka kërkuar edhe përjashtimin e saj si Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë, për çka ka ndërprerë procedimin e trajtimit të kërkesës për përjashtimin e gjyqtares A.N., dhe lëndën e ka dërguar në vendosje tek kryetari i Gjykatës së Apelit, si autoritet kompetent. Më 24.01.2023, kryetari i Gjykatës së Apelit, përmes aktvendimit AN.nr.10/2023, ka refuzuar kërkesën e paditëses V.S., për përjashtimin e kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë për vendosje lidhur me kërkesën e saj. Kurse, më 30.01.2023, si kryetare gjykatës ka marrë aktvendimin GjA.nr.54/2023, me të cilin ka refuzuar kërkesën e paditëses respektivisht ankueses V.S., për përjashtimin e gjyqtares A.N.-M., nga procedimi dhe vendosja lidhur me çështjen juridike A.nr.2401/2022, si të pabazuar. Deklaratës ia ka bashkëngjitur edhe aktvendimin e Gjykatës së Apelit dhe vendimin e lartcekur me të cilin është refuzuar kërkesa për përjashtim e gjyqtares A.N..

Pas analizimit të pretendimeve të ofruara nga parashtruesja e ankesës, deklaratës së kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe provave të cilat ia ka bashkëngjitur deklaratës së saj, vlerësoj se në rastin konkret nuk ka vend për të hapur rast disiplinore për këto arsye:

Në rastet kur një person fizik apo juridik ushtron ankesë ndaj një gjyqtari apo prokurori lidhur me ndonjë pretendim për shkelje disiplinore tek autoriteti kompetent, ky i fundit konform dispozitës së nenit 9 par.6 të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve e shqyrton ankesën brenda tridhjetë(30) ditëve nga dita e pranimit të ankesës. Kurse sipas par.7 të të njëjtit nen nëse kryetari i gjykatës apo kryeprokurori nuk e shqyrton dhe nuk vendos lidhur me ankesën ose nuk e njofton personin që ka paraqitur ankesë për arsyet e hedhjes poshtë të ankesës siç kërkohet me par.6, konsiderohet se ka kryer shkelje disiplinore.

Nga deklarata e kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe provat të cilat ia ka bashkangjitur del se e njëjta ka vendosur lidhur ankesën e palës V.S., brenda afatit tridhjetë (30) ditor nga dita e pranimit të ankesës (vendimi AD/GJTHPR/44/22 datë 12.01.2023) dhe të njëjtën ditë ky vendim edhe është ekspeduar gjë që vërtetohet nga kopja e fletores së dorëzimit dhe flete kthesat e bashkangjitura). Në fakt vendimi i është dorëzuar postës me 12.01.2023 kurse pala e ka marrë vendimin me 16 janar 2023.

Duke pasur këtë gjendje të çështjes, si autoritet kompetent vlerësojë se pretendimet e ankueses se kryetarja nuk ka vendosur brenda afatit ligjor lidhur me ankesën e saj dhe me këtë ka konsumuar shkeljen disiplinore nga par.6 i nenit 9 të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve janë të pabazuara.

Kurse, pretendimet e ankueses se kryetarja e gjykatës nuk ka vepruar as sipas kërkesës së saj të dytë për përjashtimin e gjyqtares A.N. (edhe pse Kryetarja në deklaratën e saj i ka arsyetuar edhe këto pretendime të ankueses) nuk u shqyrtuan sepse ligji nuk parasheh ndonjë afat ligjor lidhur me trajtimin e kërkesës, ndërsa sa i përket kërkesës se ankueses për përjashtimin e Kryetares konform dispozitave ligjore nuk kam kompetencë për të vendosur lidhur me përjashtimin e saj.

Nga arsyet e cekura e në bazë të nenit 9 par. 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenit 7 par.3 nënpar. 3.2 të Rregullores së KGJK-së, nr.05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Mejreme Memaj
U.D. Kryetare e Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
2. Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë,
3. Palës ankuese,
4. Arkivit të Gjykatës Supreme.